

Listimi i AK-ve dhe shkeljet e identifikuara të ligjit për prokurim publik (LPP) në strukturë gjenerale nuk shërbejnë mjaftueshëm për të ofruar zgjidhje konkrete për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Prandaj, ky raport ofron shembuj se si monitorohen AK-të përmes mekanizmave ex-ante në vendet tjera si Polonia, Hungaria dhe Bullgaria dhe do të ofroj një shembull model të ‘‘hartimit dhe vlerësimit të rrezikut’’ për monitorimet e llojit ex-post.

Ky raport po ashtu elaboron mandatin e KRPP-së në monitorimin e aktiviteteve të prokurimit publik në atë se sa AK monitorohen dhe në cilat faza. Po ashtu, cilat janë rekomandimet e këtij institucioni për përmirësimin e gjendjes aktuale të prokurimit dhe sa respektohen ato nga institucionet publike në Kosovë.